



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

## BASHKIA DIBËR

### PROJEKT-VENDIM

Nr. 14 Datë 23/08/2024

#### **PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË BASHKISË DIBËR DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ç”, nenit 55, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenit 6, shkronja “c” dhe nenit 9, të ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, nenit 28 të ligjit nr. 89/2022, vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKM-në nr. 503, datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime të vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, në VKM –në nr. 326 datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjëve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” vendimit nr. 113, datë 01.03.2023, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”,

### **K Ë R K O J M Ë**

Miratimin e nivelit të pagës për funksionet e zgjedhura dhe të emëruara, paga e grupit dhe shtesa për pozicion për nëpunësit civilë dhe të emëruar, të Bashkisë Dibër sipas klasave të përcaktuara në V.K.M nr 503, datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime të vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të

punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Lidhjes 2, të VKM –së nr. 326 datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjëve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administrates publike”, i ndryshuar, sipas tabelës vijuese.

Lidhja 5

Nr.	Emertesat e Pozicioneve te punes per çdo kategori	Kategoria	Klasa	Paga per Pozicion
1	Kryetar	Lidhja nr 1 pika c		232.500
2	Zv/Kryetar	Lidhja nr 1 pika c		187.500
3	Administrator NJA 5001-20000 banore	Lidhja nr 8		90.000
4	Administrator NJA e tjera	Lidhja nr 8		75.000
5	Sekretari Përgjithshëm	I	I-4	140.000
6	Sek.Kësh.Bashkiak	II	II-2	110.000
7	Drejtor Drejtorie	II	II-2	110.000
8	Drejtor Kabineti	II	II-2	110.000
9	Këshilltari Kryetarit	III	II-2	110.000
10	Zëdhënës Shtypi	III	III-2	87.000
11	Përgjegjës sektori /Kordinator Nj A/Kryeinspektor policia bashkiake/ Kryeinspektor IMTV	III	III-2	87.500
12	Përgjegjës sektori /Kordinator Nj A/ Kryeinspektor policia bashkiake /Kryeinspektor IMTV	III	III-3	81.500
13	Specialist grupi diplomes 1	IV	IV-2	70.000
14	Specialist i nivelit të mesëm/Inspektor policia bashkiake grupi diplomes 2	IV	IV-3	56.000
15	Specialist i nivelit të ulët grupi diplomes 3	IV	IV-4	50.000
16	Specialist (arketar, inspektor policie bashkiake magazinier arsim i mesëm)			47.000

Miratimin e nivelit te pages për funksionet e zgjedhura dhe të emëruara, paga e grupit dhe shtesa për pozicion për nëpunësit civilë dhe te emeruar, të Bashkisë Dibër sipas klasave të përcaktuara në V.K.M nr 503, datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime te vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Lidhjes 2, të VKM –së nr.326 datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjëve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administrates publike”, i ndryshuar, për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, punonjësit e çerdheve, Konviktit dhe institucioneve të varësisë sipas tabelave vijuese:

Drejtoria e Shërbimeve Publike

Lidhja 5

Nr.	Emertesat e Pozicioneve të punës për çdo kategori	Kategoria	Klasa	Paga Pozicion për
1	Drejtor Drejtorie	II	II-2	110.000
2	Përgjegjës sektori	III	III-2	87.500

3	Përgjegjës sektori	III	III-3	81.500
4	Specialist grupi diplomes 1	IV	IV-2	70.000
5	Specialist grupi diplomes 2	IV	IV-3	56.000
6	Specialist grupi diplomes 3	IV	IV-4	50.000

**Niveli i Pagave të Punonjësve të Çerdheve.**

**Lidhja 5**

Nr.	Emërtesat e Pozicioneve të punës për çdo kategori	Kategoria	Klasa	Paga Pozicion për
1	Përgjegjës në çerdhe grupi diplomës 1	IV	IV-2	67,000
2	Përgjegjës në çerdhe grupi diplomës 2	IV	IV-3	58.000
3	Edukatore në çerdhe grupi diplomës 1	IV	IV-4	52.000
4	Edukatore në çerdhe grupi diplomës 2	IV	IV-4	50,000
5	Edukatore në çerdhe grupi diplomës 3	IV	IV-4	48.000
6	Edukatore në çerdhe arsimit mesëm			47.000

**Niveli i Pagave të Punonjësve të Konviktit.**

**Lidhja 5**

Nr.	Emërtesat e Pozicioneve të punës për çdo kategori	Kategoria	Klasa	Paga Pozicion për
1	Përgjegjës në konvikt grupi diplomës I	IV	IV-2	87.500

Punonjësit arsimor dhe jo arsimor pranw drejtorisw sw kopshteve, konviktit dhe QKF-Sw mbwshteten nw VKM nr.425 datw 26.06.2024

**Niveli i Pagave të Punonjësve të Qendrës Balneare**

**Lidhja 5**

Nr.	Emërtesat e Pozicioneve të punës për çdo kategori	Kategoria	Klasa	Paga Pozicion për
1	Drejtor ,Administrator	II	II-2	

				110,000
2	Mjek	III	III-2	80,000
3	Përgjegjës sektori	III	III-2	80,000
4	Specialist ,infermiere i nivelit të lartë kryeinfermiere	IV	IV-2	55,000
5	Specialist,infermiere grupi diplomës 1	IV	IV-3	48,000
6	Specialist ,infermiere grupi diplomës 2	IV	IV-3	46,000
7	Specialist ( arketar , magazinier ) arsim i larte	IV	IV-2	55,000
8	Infermiere arsimit mesëm			43,000
9	Mirëmbajtës			43,000

**Niveli i Pagave të Punonjësve të Klubit  
Shumësportesh Korabi**

**Lidhja 5**

Nr.	Emërtesat e Pozicioneve të punës për çdo kategori	Kategoria	Klasa	Paga Pozicion për
1	Sekretar Klubi	IV	IV-2	70.000
2	Sekretar Klubi	IV	IV-3	65.000
3	Përgjegjës sektori sipas nivelit diplomes	IV	IV-4	60.000
4	Përgjegjës sektori sipas nivelit diplomes	IV	IV-4	55.000

**Niveli i Pagave të Punonjësve të Klubit  
Futbolli Korabi**

**Lidhja 5**

Nr.	Emërtesat e Pozicioneve të punës për çdo kategori	Kategoria	Klasa	Paga Pozicion për
1	Sekretar Klubi	IV	IV-2	70.000
2	Sekretar Klubi	IV	IV-3	65.000
3	Përgjegjës sektori grupi diplomës 1	IV	IV-4	60.000
4	Përgjegjës sektori grupi diplomës 2	IV	IV-4	55.000

Niveli i Pagave të Punonjësve të Qendrës  
Kulturore

Lidhja 5

Nr.	Emertesat e Pozicioneve te punes per çdo kategori	Kategoria	Klasa	Paga Pozicion per
1	Drejtor Drejtorie	II	II-2	110.000
2	Përgjegjës sektori	III	III-2	70.000
3	Përgjegjës sektori	III	III-3	60.000
4	Specialist grupi diplomës 1	IV	IV-4	52.000
5	Specialist i grupi diplomës 2	IV	IV-4	50.000
6	Specialist grupi diplomës 3	IV	IV-4	45.000

Pagat e punonjësve administrative, të jenë në masën 47,000 (dyzete e shtatë mijë) lekë në muaj sipas pikës 11, të VKM-së 328 dt 31.05.2023 të ndryshuar.

Pagat e punonjësve mbështetës të jetë sipas VKM –në nr. 326 datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjëve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar.

Këshilltarët e Këshillit Bashkiak Dibër, të shpërblehen në masën 10 % e pagës së Kryetarit të Bashkisë Dibër,

Miratimin e pagave për punonjësit që punojnë në pozicione që lidhen me procesin e informatizimit, të përfitojnë një shtesë, sipas pikës 4/ atë VKM-së 328 dt 31.05.2023 të ndryshuar.

Miratimin e pagave për punonjësit me kontratë pune

Përgjegjës zyre niveli I i diplomës në vlerën 65.000 pozicioni

Përgjegjës zyre niveli II i diplomës në vlerën 60.000 pozicioni

Specialist niveli I i diplomës në vlerën 55.000 pozicioni

Specialist niveli II i diplomës 48.000 pozicioni

Specialist niveli III i diplomës 42.000 pozicioni

Specialist në NJA në vlerën 40.000 pozicioni

Shtesa për vjetërsi në punë nga 2% për çdo vit deri në 25 vjet, që aktualisht llogaritet mbi pagën e grupit, nëpërmjet VKM nr. 503, datë 1.8.2024, do të jepet deri në 30 vjet dhe llogaritet mbi shtesën e pozicionit, në masën si vijon:

- 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1 – 10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11 - 20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21 – 30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.

Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit, nëpërmjet VKM nr. 503, datë 1.8.2024, do të jepet, në masën si vijon:

Grupi i diplomës	Niveli i kualifikimit sipas kornizës shqiptare të Kualifikimit (KSHK)	Vlera e shtesës së nivelit të kualifikimit (leke/muaj)
1	Niveli 7 i KSHK-se (master i Shkencave, Master i arteve, Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohezgjatje normale 2 vite akademike) të barazvlefshëm me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë)	14,000
2	Niveli i 7 i KSHK-se (master profesional) të barazvlefshëm me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë)	12,000
3	Niveli i 6 i KSHK-se (bachelor) të barazvlefshëm me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë)	10,000

Në pikën 3/d e VKM 503 dt 01.08.2024 shtesa për natyrë të veçantë pune, policëve bashkiak dhe punonjësve mbështetës, për natyrë të veçantë pune u jepet një shtesë mbi pagën bazë mujore të klasës përkatëse, në masën 4 000 (katërmijë) lekë në muaj.

Në pikën 9 të VKM 326 datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjëve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", i ndryshuar për punë të vështira e të demshme për shëndetin, punonjësve u jepet shtesë mbi page sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë, në përputhje me vlerësimin që bëhet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për shkallën e vështirësisë dhe dëmshmërisë në shëndet. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë më 1 Shtator të vitit 2024 dhe do të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2024.

Dr. i B. Njerëzore  
Malborë Lala

Drejtor Juridik  
Ismet Saraci

Drejtoreshë Finance  
Çeljeta Zuna

Dr. Shërb. Publike  
Bedri Kamberi

Zv/Kryetar  
Ruzhdi DEDA

KRYETARI

Rahim SPAHIU

## RELACION

### **“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË DIBËR DHE INSTITUCIONET E VARËSISË” PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1.1, shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ç”, nenit 55, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenit 6, shkronja “c” dhe nenit 9, të ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, ndryshimet e sipërcituara, bazuar në nenin 28 të ligjit nr. 89/2022. Nisur nga ndryshimet e sipërcituara, propozojmë miratimin e pagave të Policisë Bashkiake.VKM-në nr. 503, datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime të vendimit nr. 328, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, në VKM –në nr. 326 datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjëve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike” vendimit nr. 113, datë 01.03.2023, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”,

Në kuadër të ndryshimeve në legjislacionin e pagave, konkretisht ndryshimit të VKM-së për pagat e punonjësve të Njësive të qeverisjes vendore, Drejtoria e e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Finances ka pasqyruar ndryshimet në nivelin e pagave për të gjitha kategoritë e funksionarëve, nëpunësve civil, punonjësve administrativ të Bashkisë Dibër, duke ja parashtruar Këshillit Bashkiak informacionin si më poshtë vijon: Këto ndryshime vijnë si domosdoshmëri e:

- Rritjes së pagës në administratën qendrore e vendore.

- Ndryshimeve në legjislacionin e pagave vendimet e Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të administratës shtetërore, punonjësve mbështetës, punonjësve arsimor, punonjësve të policisë, etj

- Rritjes së inflacionit.

- Rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore, energjisë elektrike, karburanteve etj me qëllim zbutjen e pasojave të krizës ekonomike.

Ky projektvendim me qëllim që të mundësojë dhe të realizojë përmirësimin në nivelin e pagave me synimin e ngushtimit të hendekut sipas hierarkisë së pagave të tyre, duke vlerësuar rëndësinë dhe përgjegjësitë, ka parashtruar:

a) Ndryshimin e llogaritjes së elementit "shtesë për vjetërsi në punë", duke e njësuar me mënyrën e llogaritjes së këtij elementi për nëpunësit e tjerë të institucioneve të administratës publike, qendrore e vendore.

Shtesa për vjetërsi në punë nga 2% për çdo vit deri në 25 vjet, që aktualisht llogaritet mbi pagën e grupit, nëpërmjet vendimit nr.503, datë 1.8.2024, do të jepet deri në 30 vjet dhe llogaritet mbi shtesën e pozicionit, në masën si vijon:

- 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1-10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11-20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21-30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.

Aplikimi formulës së re të “shtesës për vjetërsi në punë” bëhet me qëllim unifikimin e elementëve të pagës dhe përafrimin e pagave të Insitucioneve tona me nivelet aktuale të pagave të Insitucioneve të tjera të varësisë në nivel qendror.

#### **Në Lidhjen nr.5 për miratimin e nivelit të pagave të aparatit të bashkisë, institucioneve të varesise, çerdheve dhe konviktit**

propozohet niveli i pagës për funksionet e zgjedhura dhe të emëruara, paga e grupit dhe shtesa për pozicion për nëpunësit civilë të Bashkisë Dibër sipas klasave të përcaktuara në vendimin nr. 503, datë 01.08.2024, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Pagat për aparatit të bashkisë dhe institucioneve të varesise kanë një rritje në krahasim me pagën aktuale duke e vendosur në një nivel mesatar sipas VKM nr 503 datë 01.08.2024.

*Ndryshimi i pagës për pozicionin të edukatoreve në Çerdhe bëhet me qëllim përafrimin e tyre me pagën e edukatoreve në Kopshte sipas VKM nr.425, datë 26.06.2024 “Për pagat e punonjësve të sistemit arsimor”.*

c) Në lidhjet nr.4, , punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme për natyrë të veçantë pune u jepet një shtesë mbi pagën bazë mujore të klasës përkatëse, në masën 4 000 (katërmijë) lekë në muaj.

Në këtë kuadër është parë e domosdoshme, me qëllim garantimin e shpërblimit të drejtë e të barabartë të të punësuarve si dhe motivimin dhe rritjen e performancës në punë të jepet shtesa për natyrë të veçantë pune, mbi pagën bazë mujore, në masën 4 000 (katërmijë) lekë në muaj për të gjithë kategoritë e punonjësve të cituar më lartë.

**Në Lidhjen nr.5** propozohet niveli i pagës për funksionet e zgjedhura dhe të emëruara, paga e grupit dhe shtesa për pozicion për nëpunësit civilë të Bashkisë Dibër sipas klasave të përcaktuara në vendimin nr. 503, datë 01.08.2024, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Në pikën 4 të p/vendimit, bazuar në pikën c të nenit 9 të ligjit nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, është paraqitur për miratim shpërblimi mujor i këshilltarëve të Këshillit Bashkiak Dibër në masën 10% të pagës mujore të Kryetarit të Bashkisë

Aplikimi i pagës sipas lidhjeve të mësipërme do të fillojë nga data 1 shtator 2024. Te gjitha pagat janë të miratuara në Buxhetin e vitit 2024.



Fondi per perballimit e shtesave te pagave perballohet nga transferta e pakushtezuar dhe nga te ardhurat ne buxhetin e vitit 2024 ne artikullin 600 dhe 601 si dhe ne alokimin e propozuar ne kete mbledhje keshilli bashkiak.  
Duke shpresuar në miratimin e këtij projekt-vendimi nga ana Juaj.

Konceptoi:  
Çeljeta Zuna  
Malbora Lala  
Andon Sina  
Pranvera Uka  
Ismet Saraci

**MIRATOI**

**KRYETARI**

**Rahim SPAHIU**